

AKT-THEMELIMI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“URANO ENGINEERING CONSULTANTS” SH.P.K

Ne kete akt-themelimi:

- “Ligji” eshte Ligji Nr.9901 ,date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”; Ligji Nr.9723,date 03.05.2007 ,per “Qendren Kombetare te Rregjistrimit”
- “Statuti” eshte statuti i shoqerise;
- “Dite te plota” ne lidhje me periudhen e nje njoftimi eshte periudha qe nuk perfshin ditet kur eshte dhene ose kur konsiderohet se eshte dhene njoftimi dhe ditet per te cilen eshte dhene ose hyn ne fuqi njoftimi.

NENI 1

Sot,me date 25/04/2018,une shtetasi:


1.**ALLIU Feim** I biri I Xhaferrit,I ditelindjes 04/10/1951,banues ne Durres,Lagjia3,Rruga “EGNATIA”,Pallati “NATOJA”,Nr.16.

Themelohet Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin “**URANO ENGINEERING CONSULTANTS**” shpk duke pershtatur Statutin e ne perputhje me nenin 230 te Ligjit Nr.9901,date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare,e cila eshte nje person juridik shqiptar dhe si e tille do te filloje veprimtarine pasi te jete rregjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne Drejtorine Tatimore.Veprimtaria e shoqerise do te zhvillohet duke u mbeshtetur ne kete akt themelimi,statutit bashkelidhur dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 2

Shoqeria do te kryeje veprimtarine e meposhtme:

- 1.Projektim,zbatim,supervision dhe kolaudim i ndertimeve civile,industrial,sociale,rrugore, portuale,aeroportuale etj
- 2.Prodhim,tregetim i produkteve kimike per ndertimet,punime laborator,ndertime civile etj.
- 3.Analiza laboratorike te materialeve te ndryshme te ndertimit,gjeoteknike etj.
- 4.Transportim dhe spedicion te mallrave te ndryshme per vehten apo te trete,brenda dhe jashte vendit.
- 5.Sherbime ne sektore te ndryshem si ne ate arsimor,shendetesi,sport etj.



Per permbushjen e objektit te veprimtarise shoqeria mund te marre pjese ne ndermarrje apo shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte ose te perafert me te sajine dhe mund te kryejne direkt ose indirekt te gjitha operacionet tregtare dhe financiare me karakter te luajtshem dhe te paluajtshem.

Shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo valuta te tjera prane bankave shqiptare dhe te huaja ,duke mundur gjithashtu te disponoje lirisht mjetet monetare te akumuluar ne to, konform legjislacionit ne fuqi.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pakufizuar.

NENI 4

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen : Autostrada Tirane-Durres, Km 29, Vrrin, Durres.
Numri i Telefonit : + 355 67 20 22 609.

NENI 5

Administrimi dhe perfaqesimi i shoqerise i besohet nje administratori te vetem. Administratori emerohet per nje periudhe te pacaktuar, pervec rasteve kur jep dorheqjen apo shkarkohet nga Asambleja e Ortakeve. Me vendim te ortakut te vetem Feim ALLIU, administrator i shoqerise do te emerohet ky i fundit me nje mandat 5 (pese) vjecar, te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit te shoqerise.

Administratori zoteron kompetenca te pakufizuara per realizimin e veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te atyre qe akti themelues dhe statuti ja njeh Asamblese se ortakëve apo organeve te tjera drejtuese te shoqerise. Per permbushjen e detyres se tij mund te vere ne levizje instanca juridike dhe administrative, duke emeruar avokate dhe duke leshuar prokurat perkatese ne raste gjyqesh, te kryeje operacione bankare duke perfshire hapjen e llogarive rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, realizimin e terheqjeve/derdhjeve me para ne dore etj.


NENI 6

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte **100 LEK**. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e meposhtme :

► Ortaku themelues **Feim ALLIU**, lloji i kontributit para, vlera e kontributit **100 LEK**, kuota e zoterimit ne kapitalin e shoqerise **100 %**.

1 Kuote e barabarte 100% e vleres

Vlera totale e kapitalit te regjistruar **100 LEK**,
Vlera e paguar **100 LEK**



NENI 7

Viti ekonomik fillon me 01 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti, viti i pare ekonomik mbyllet me date 31 Dhjetor 2018.

NENI 8

Ne nje liber te posacem te shoqerise shenohet kapitali themeltar dhe vlera e kontributeve relative per seicilin ortak.

Ortakët mund të zmadhojnë kontributin e tyre dhe për pasojë kuotën e tyre duke depozituar fitimet nga veprimtaria e shoqerise konforme pershkrimeve të bera ne Statutin e shoqerise.

NENI 9

Ne perfundim te vitit ekonomik, pas miratimit te bilancit, asambleja vendos per ndarjen e fitimit neto (dmth, pasi jane ndare fondet per likuidimet e detyrimeve ndaj te treteve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme) ndermjet ortakëve. Per humbjet pergjigjet ekskluzivisht shoqeria me kapitalin e saj.

NENI 10

Ortakët dhe administratorët janë të detyruar të ruajnë sekretin mbi të dhënat, njohuritë dhe eksperiencat e fituara gjatë veprimtarisë, qoftë dhe pjesore të tyre.

Ata janë përgjegjës për pasojat e mundshme negative nga shkelja e tyre.

Përgjegjësia për sa është specifikuar në këtë nen edhe ekspertin kontabel të miratuar.

NENI 11

Ortakët janë përgjegjës ndaj të treteve për demet që mund të shkaktohen nga anulimi apo deklarimi i pavlefshëm i këtij akti themelues.

NENI 12

Për sa nuk specifikohet shprehimisht në këtë akt themelimi, vlejne nenet e statutit bashkelidhur.

**Emri dhe nënshkrimi i Ortakut themelues
te shoqerise "URANO ENGINEERING CONSULTANTS" shpk**

Feim ALLIU

